



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 22.30.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË KOMUNËS SË
MAMUSHËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikën e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Mamushës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Lavdim Maxhuni (Udhëheqës ekipi) Ernes Beka dhe Fetah Osmani (anëtarë ekipe), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të auditimit Florim Beqiri.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	10
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	16
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	24
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	25
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	28
Shtojca IV: Letër konfirmimi	32

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Komunës së Mamushës për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 06.12.2016.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërdrejt cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksim i çështjes

Si theksim i çështjes dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se asnjë pasuri e komunës nuk ishte regjistruar në SIMFK dhe nuk ishte prezantuar në PFV. Po ashtu, komuna kishte bërë keqklasifikime të shpenzimeve dhe nga kategoria mallra dhe shërbime kishte paguar 9,000€ për subvencione dhe transfere.


Për më gjerësisht, shih Pjesën 1.1 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

¹ Termi "Plani i Jashtëm i Auditimit" është zëvendësim i termit "Memorandumi i Planifikimi të Auditimit"

Dëshirojmë të falënderojmë Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



Përgjigja e Menaxhmentit në auditimin 2016

Kryetari i Komunës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport, si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

Ne e konsiderojmë si të kryer faktin që Kryetari:

- Do ta shqyrtoj raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Deri në fund të muajit janar 2018, do ta diskutoj në Asamblenë Komunale progresin lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PFV 2017 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Mamushës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren e MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi ynë është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se asnjë pasuri e komunës nuk ishte regjistruar në SIMFK dhe nuk ishte prezantuar në PFV.

Po ashtu, komuna kishte bërë keq klasifikim të shpenzimeve, për shkak se nga kategoria mallra dhe shërbime kishte paguar 9,000€ për subvencione dhe transfere. Këto keq klasifikime kishin të bëjë me pagesat e bërë për lehonat që janë banore të Komunës së Mamushës.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Kryetari i Komunës së Mamushës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).
- Pasqyrat nëntëmujore financiare dhe
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit më kohë;

Sa i përket kërkesave më lartë, komuna i kishte trajtuar dhe është në pajtim me kornizën raportuese.

Në draft PFV ishin të nevojshme disa korrigjime financiare dhe ne kemi dhënë sugjerime për të përmirësuar cilësinë e tyre, si në vijim.

- Te neni 14 Raporti i ekzekutimit të buxhetit - Dalja e parasë së gatshme nga llogaria e Thesarit - pagesat direkte prej 22,648€ ishin prezantuar gabimisht pasi që kjo shumë nuk kishte kaluar përmes LLVTH;
- Te neni 19 Raport për pasurinë jo financiare - komuna nuk kishte prezantuar asnjë vlerë të pasurive kapitale dhe jokatitale.

Sugjerimet tona janë marr parasysh nga komuna dhe gabimet e përmendura më lart janë korrigjuar, me përjashtim të çështjeve të pasurive dhe keq klasifikimit për të cilat çështje ne e kemi theksuar opinionin. Shih nënkaptullin 1.1 Opinioni i auditimit.

DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI I KOMUNËS

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, është e saktë për shkak se gjatë auditimit nuk janë identifikuar gabime materiale, përveç çështjeve të përmendura në opinion e auditimit të cilat ne i kemi konsideruar jo materiale.

1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për t'i hequr gabimet në klasifikimin e shpenzimeve dhe për të siguruar se të gjitha pasuritë që janë në pronë të komunës, të regjistrohen dhe prezantohen në PFV.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për komunën që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo pasqyron veprimet e marra të menaxhmentit në zhvillimin dhe përmirësimin e proceseve ekzistuese dhe kontrolleve. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vet-vlerësimit siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna në listën e vetvlerësimit të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të nxisin përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes të komunës veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Lista kontrolluese e vet-vlerësimit, e plotësuar nga komuna, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi ekzistimin e aranzhimeve ekzistuese që nuk bazohen në dëshmi.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit. Komuna nuk kishte arrit t'i zbatoj në shkallën e mjaftueshme rekomandimet e vitit të kaluar, vetëm 1 nga 13 rekomandimet e dhëna ishin zbatuar plotësisht.

Komuna nuk e kishte hartuar planin strategjik të zhvillimit dhe nuk kishte hartuar listën e rreziqeve me të cilën mund të ballafaqohet komuna.

Buxheti për shpenzime kapitale ishte shpenzuar vetëm 76%. Një shfrytëzim kaq i ultë i buxheti për kapitale është i paarsyeshëm për faktin se komuna kishte buxhet të mjaftueshëm nga të hyrat vetjake (96,055€), të cilat nuk i kishte shpenzuar në 2016 por i kishte bartur në vitin 2017.

Në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin, auditimi ynë ka shpalosë ekzistencën e disa dobësive si rezultat i mos zbatimit të rregulloreve të cilat përfshijnë kryesisht prokurimin tek mallrat dhe shërbimet, menaxhimin e pasurive, të hyrat dhe menaxhimi i obligimeve të papaguara.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2015 kishte rezultuar me 13 rekomandime, prej të cilave 10 ishin me prioritet të lartë dhe 3 me prioritet të mesëm. Menaxhmenti kishte përgatitur një Plan Veprimi në të cilin paraqitet mënyra se si të zbatohen rekomandimet e dhëna.

Raporti i auditimit i vitit të kaluar nuk ishte diskutuar në Asamblenë Komunale.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, 1 (një) rekomandim me prioritet të lartë ishte zbatuar, 4 (katër) janë në proces të zbatimit (3 me prioritet të lartë dhe 1 me prioritet të mesëm) dhe 8 (tetë) rekomandime nuk janë zbatuar (6 me prioritet të lartë dhe 2 me prioritet të mesëm). Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 1 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

E gjetura Nga përshkrimi më lartë shihet se rekomandimet e vitit paraprak nuk janë trajtuar me vëmendjen e duhur, dhe si rezultat i kësaj, gati 2/3 e rekomandimeve nuk janë zbatuar. Kjo ka ndodhur për shkakun se komuna nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm. Si të tilla, në këtë raport auditimi, përsëri janë ngritur çështjet për përmirësim të aktiviteteve të caktuara.

Rreziku Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe, si menaxhimi i pasurive, të hyrat, qeverisja e mirë kanë rezultuar në:

- Qeverisje jo të mirë e cila redukton mundësinë që menaxhmenti të merr masa me kohë ndaj sfidave financiare, si dhe potencialisht mund të rezultojë me humbje financiare;
- Kontrolle të pamjaftueshme tek të hyrat nga tatimi në pronë; dhe
- Menaxhim jo i duhur i parasë së imët.

Rekomandimi 2 Kryetari duhet të vendos dha zbatoj mekanizma konkret të llogaridhënies ndaj të gjithë personave përgjegjës të ngarkuar për zbatimin e rekomandimeve. Pas pranimit të këtij raporti, ne sugjerojmë që të përgatitet një plan i rifreskuar i veprimit për të zbatuar rekomandimet e këtij viti dhe rekomandimet e vitit të kaluar, duke përcaktuar qartë afatet kohore, veprimet dhe personat përgjegjës për realizimin e këtij plani. Një proces monitorimi, po ashtu duhet zbatohet.

2.2 Pyetëtori i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese. Konkluzionet tona nuk kanë për qëllim të komentojnë cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit, por do të pasqyrojnë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 2 - Pyetëtori i vet-vlerësimit - Prioritet i lartë

E gjetura Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë komponenta. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se çështjet që nuk ishin adresuar plotësisht ishin si në vijim:

1. Lista e vetvlerësimit të plotësuar ka vërtetuar se komuna ende nuk ka krijuar procedura formale dhe të dokumentuara të identifikimit dhe menaxhimit të rreziqeve në nivel të organizatës që do të zbusnin ekspozimin ndaj rreziqeve që ndërlidhen me arritjen e objektivave të përcaktuara;
2. Komuna nuk ka strategji gjithëpërfshirëse të zhvillimit ekonomik lokal. Për më tepër, referoju nënkapitullit 2.3.1;
3. Ne kemi rishikuar raportimet menaxheriale që bëhen nga drejtoritë tek kryetari i komunës, dhe më gjërësisht kjo është trajtuar në hollësi në kapitullin 2.3.2; dhe
4. Progresi lidhur me monitorimin e objektivave nuk monitorohet rregullisht dhe si rezultat i kësaj nuk analizohen shkaqet për dështimet e mundshme.

Rreziku Aranzhimet e dobëta të qeverisjes ndikojnë në dobësimin e proceseve strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.

Rekomandimi 3 Kryetari duhet të sigurojë se është rishikuar plotësisht i listës kontrolluese të vetvlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës. Auditimi i brendshëm duhet të përfshihet si pjesë e rishikimit të cilësisë.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit Komuna operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike

Të gjitha organizatat buxhetore për Komuna janë të obliguara të përgatisin dhe të përcjellin planet strategjike në nivel të organizatës, si: planet urbanistike, hapësinore, plani operativ emergjent, strategjia e zhvillimit rajonal, plani strategjik kundër korrupsionit. Komuna posedon disa plane në nivel të drejtorive, si psh: Plani Zhvillimor Komunal 2014-2023, plani urbanistik, Plani lokal i mjedisit për Komunën e Mamushës 2014-2019.

Çështja 3 - Mungesa e një plani strategjik gjithëpërfshirës në kuadër të Komunës

- E gjetura** Komuna nuk posedon një plan strategjik gjithëpërfshirës me objektiva afatgjate ku përshkruhet qartë Vizioni dhe Misioni i cili prezanton orientimin dhe synimet e Komunës në një periudhë afatmesme të zhvillimit. Po ashtu, nuk ka të hartuar strategji kundër korrupsionit, nuk posedon plan operativ emergjentë, etj.
- Rreziku** Mungesa e një plani strategjik gjithëpërfshirës rrezikon prioritetet e çështjeve kyçe të cilat kanë të bëjnë me orientimin dhe zhvillimin e komunës në periudha afatgjata. Paqartësia mbi zbatimin e strategjisë, bën të pamundur që të përcjellët përmbushja e objektivave në pikëpamje të vizionit të Komunës si një ndër kushtet esenciale të qeverisjes së mirë.
- Rekomandimi 4** Kryetari duhet të miratojë një plan të përgjithshëm strategjik për komunën duke përfshirë koston e strategjisë i cili do të përcaktojë objektivat afatgjata dhe të shërbej si platformë orientuese për hartimin e planeve vjetore. Më pas, duhet të hartoj planin e veprimit për monitorimin e arritjes së objektivave duke vendosur funksione efektive të mbikëqyrjes.

2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 4 – Dobësi në kontrollet menaxheriale – Prioriteti i mesëm

- E gjetura** Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të komunës ka nxjerrë në pah një raportim të dobët financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat tek menaxhmenti i lartë si dhe analiza të pakompletuara të ofrimit të shërbimeve. Kjo, për shkak se formati i raporteve javore nga drejtoratet që dorëzohen tek kryetari i komunës nuk ofron shpjegime rreth variancave në buxhet dhe se parashikimet buxhetore nuk janë azhurnuar në baza mujore. Ngjashëm, aktivitetet operative nuk menaxhohen në mënyrë sistematike.
- Rreziku** Cilësia e raportimit financiar dhe të aktiviteteve tek menaxhmenti i lartë e ka reduktuar aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar aktivitetet e Komunës në mënyrë pro aktive si dhe ka ulur efektin e kontrolleve buxhetore. Kjo mund të rezultojë në deficit ose suficit të paplanifikuar dhe të vonojë veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato.
- Rekomandimi 5** Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme për këtë.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Komuna nuk e ka të themeluar Njësine e Auditimit të Brendshëm (NJAB) siç kërkohet me Udhëzimin Administrativë Nr. 23/2009 për themelimin dhe funksionimin e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik. Ky udhëzimi përcakton se subjekti publik me buxhet 1 deri 3 milionë duhet të ketë një auditor të brendshëm.

Çështja 5 - Mungesa e Auditimit të Brendshëm - Prioriteti i lartë

- E gjetura** Edhe pse ishte rekomandim i vitit të kaluar, komuna nuk ka bërë përpjekje që shërbimet e auditimit të brendshëm t'i siguroj nga bashkëpunimi me ndonjë organizatë tjetër buxhetore ose të kërkoj mbështetje nga Ministria e Financave.
- Rreziku** Mungesa e auditimit të brendshëm mund të rezultojë me vazhdimin e përsëritjes së dobësive në sistemet kyçe të kontrollit të brendshëm. Për më tepër, menaxhmenti mund të mos i identifikojë dhe reagojë me kohë ndaj parregullsive dhe dobësive të kontrollit.
- Rekomandimi 6** Kryetari i Komunës duhet të siguroj përmbushjen e kërkesës ligjore, respektivisht të rekrutoj një auditor të brendshëm. Nëse kjo kërkesë nuk mund të realizohet, atëherë shërbimi i auditimit të brendshëm, të kryhet nga Ministria e Financave, apo në bashkëpunim me ndonjë komunë tjetër.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin 2, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Për komunën, shpenzimet mbeten fushë ku nuk janë duke u zbatuar kontrollet në nivelin e pritur dhe kjo mund të rezultojë në vlerë të dobët për para si dhe shfrytëzim i parasë së imët jo në pajtim me rregullat në fuqi. Fushat tjera ku nevojiten më shumë përmirësime janë të hyrat nga tatimi në pronë, taksa për biznese, planifikimi i buxhetit dhe realizimi i tij, menaxhimi i pasurive, menaxhimi i obligimeve të papaguara.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Pranimet	2015 Pranimet	2014 Pranimet
Të hyrat vetjake	64,900	64,900	56,243	52,763	62,498

Komuna, nga të hyrat vetjake të planifikuara kishte inkasuar 87%. Në totalin e të hyrave vetjake të realizuara janë edhe të hyrat nga gjobat e trafikut (4,661) gjobat nga gjykata(470). Mirëpo, këto të hyra nuk janë shpenzuar në vitin 2016. Nëse të hyrave të mbledhura dhe të pa shpenzuara të këtij viti (56,243) i shtohet edhe shuma e bartur e të hyrave nga viti 2015 me vlerë 39,815€, atëherë totali i të hyrave për bartje në vitin 2017 është 96,058€.

Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	1,473,046	1,562,021	1,440,614	1,359,737	1,301,902
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,408,146	1,429,251	1,412,667	1,285,758	1,264,363
Të bartura nga viti paraprak ³ -	0	66,557	26,742	59,900	0
Të hyrat vetjake ⁴	64,900	64,900	0	1,300	17,987
Donacionet e brendshme	0	0	0	5,600	5,150
Donacionet e jashtme	0	1,313	1,205	7,179	14,402

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 88,975€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak, në total prej 66,557€, granti i qeverisë në shumë 21,105€, si dhe donacioneve të jashtme në shumë prej 1,313€.

Në vitin 2016, komuna ka shpenzuar 92% të buxhet final, ngjashëm me shkallën e shpenzimeve në vitin e kaluar. Nga kjo mund të konkludojmë se shpenzim i buxhetit në nivel të përgjithshëm ishte mjaft i lartë.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	1,473,046	1,562,021	1,440,614	1,359,737	1,301,902
Pagat dhe Mëditjet	825,709	870,709	856,690	840,401	784,127
Mallrat dhe Shërbimet	197,534	230,187	227,852	100,327	114,566
Shërbimet komunale	23,000	23,000	22,953	22,943	21,289
Subvencionet dhe Transferet	2,466	2,466	2,400	3,000	2,976
Investimet Kapitale	424,337	435,659	330,719	393,066	378,944

² Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Çështja 6 – Realizimi i buxhetit – Prioriteti i lartë

- E gjetura** Buxheti për shpenzime kapitale ishte shpenzuar 76%, një normë relativisht e ultë. Një shfrytëzim kaq i ultë i buxhetit për kapitale, është i pa arsyeshëm për faktin se komuna kishte buxhet të mjaftueshëm nga të hyrat vetjake (96,055€), të cilat nuk i kishte shpenzuar në 2016 por i kishte bartur për tu shpenzuar në vitin 2017.
- Rreziku** Shfrytëzimi jo mjaft efektiv i fondeve në dispozicion për realizimin e projekteve kapitale, do të rezultojë me një numër të reduktuar të projekteve dhe mos arritjen e objektivave të organizatës në fushën e investimeve.
- Rekomandimi 7** Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar tek kategoria investime kapitale. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në 2016 ishin 56,243€. Zërat kryesor që përbëjnë shumat e mbledhura janë: të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga taksa administrative, etj.

Çështja 7 – Tatimi në pronë – Prioriteti i lartë

- E gjetura** Komuna nuk kishte arritur të kryej verifikimin e 1/3 së pronave të paluajtshme siç kërkohet me Ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme nr. 03/L-204 dhe udhëzimin administrativ në fuqi. Nga gjithsej 1059 prona, deri më tani ka arrit të verifikoj vetëm 48 sish. Ne kemi vërejtur se komuna nuk ka arritur të azhurnoj sistemin me të dhëna, sepse ka pasur mungesa të zyrtarëve anketues në terren për verifikim të pronave.
- Sipas nenit 9 të Ligjit mbi tatimin në pronë, çdo person fizik i cili deri më 1 mars të vitit fiskal deklaron se prona ose njësia e banimit i shërben si vend kryesor për banim, i lejohet zbritja prej 10,000€ nga vlera e tatueshme e pronës. Ne kemi identifikuar gjashtë raste ku komuna nuk kishte vepruar në përputhje me ligjin për arsye se kishte tatimpagues që posedonin dy apo më tepër prona të regjistruara si banim kryesorë dhe për secilën pronë ju kishte aplikuar zbritja prej 10,000€.

Rreziku Mos verifikimi i 1/3 të pronave mund të rezultojë me mangësinë e informatave të plota të pronës së tatueshme aktuale, me ndikimin e mundshëm që të hyrat e vlerësuara për tatimin në pronë të ulen.

Mos aplikimi i ngarkesave sipas kërkesave ligjore të tatimit në pronë rrit rrezikun që të hyrat prej kësaj kategorie të jenë më të ulëta.

Rekomandimi 8 Kryetari duhet të siguroj se verifikimi i pronave komunale të bëhet siç parasheh ligji në mënyrë që në bazën e të dhënave të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale tek pronat, të vlefshme për bazën e tatueshme. Gjithashtu, veprime shtesë duhet të ndërmerren për të siguruar se zbritjet për 10,000€ aplikohen në pajtim me nenin 9 të ligjit mbi tatimin në pronë.

Çështja 8 - Të hyrat nga taksa komunale për biznese - Prioritet i mesëm

E gjetura Komuna për vitin 2016 nga taksa për ushtrimin e veprimtarisë kishte planifikuar që të realizoj 10,510€, ndërsa kishte inkasuar 3,090€. Ne kemi testuar 7 mostra dhe kemi vërejtur se bizneset nuk i kryejnë obligimet sipas aktvendimit që ju dërgon komuna. Borxhi nga mostrat e testuara ishte 12,323€. Menaxhmenti i komunës nuk kishte marrë masa adekuate për t'i detyruar obliguesit që t'i kryejnë obligimet ndaj komunës.

Rreziku Politikat e inkasimit duket të jenë të dobëta për të siguruar maksimizimin e të hyrave. Vonesat në mbledhjen e të hyrave sjellin dështimet në vendimmarrjen e menaxhmentit për financimin e projekteve të parashikuara.

Rekomandimi 9 Kryetari i Komunës duhet të siguroj se do të merren masa përmes mekanizmave efektiv për t'i mbledhur borxhet e prapambetura në mënyrë që të rritet inkasimi i të hyrave dhe baza për financimin e projekteve të parashikuara.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti i planifikuar për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 870,709€, ndërsa shpenzimet 856,690€ apo 98%.

Ne testuam pajtueshmërinë e listave të pagave, rekrutimet, largimet, pushimet e lehonave, pensionet dhe pagesat për anëtarët komunal. Po ashtu, kemi rishikuar nëse punonjësit janë paguar sipas kontratës. Nga mostrat e testuara, nuk kemi hasur ndonjë çështje për t'u raportuar.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe shërbime komunale në vitin 2016 ishte 253,187€. Prej tyre ishin shpenzuar 250,805€ apo 99%. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet komunale si: derivatet, furnizimet për zyre dhe ato mjekësore, furnizime me dru dhe thëngjill, shpenzimet kontraktuese, dhe riparimi i automjeteve etj.

Çështja 9 – Furnizime jashtë kontratës dhe dobësi në menaxhimin e parasë së imtë - Prioritet i lartë

E gjetura Gjatë rishikimit të mostrave në 2 (dy) pagesa për kontratën “Furnizime mjekësore” kemi vërejtur se komuna ishte furnizuar me artikuj jashtë kontratës. Nga gjithsej 39 artikuj të furnizuar, 13 ishin jashtë kontratës. Vlera e këtyre furnizimeve jashtë kontrate ishte 875€.

Ne kemi vërejtur se komuna kishte bërë shpenzim si një pagesë të vetme përmes parasë se imët vlerën prej 500€ për shpenzime të transportit në kundërshtim me kërkesat ligjore. Neni 29 pika 6 e Rregullës 01/2013 Për shpenzimin e parasë publike, ndër të tjera përcaktohet se “paratë e imëta mund të shpenzohen për mallrat ose shërbimet me vlerë totale të kombinuar jo më shumë se 100 euro”.

Po ashtu, ishin bërë pagesa nga fondi paraja e imët jo në pajtim me rregullën 01/2013, si: mirëmbajtja e ndërtesave 2,215€, mirëmbajtje e auto-rrugëve lokale 1,299€, shërbime shtypjeje 911€, furnizim me veshmbathje 741€, mirëmbajtja e shkollave 759€, mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve 476€ për të cilat shpenzime ka mund të bëhen përmes procesit të rregullt të shpenzimeve.

Rreziku Furnizimi i artikujve jashtë kontratës rrit rrezikun që komuna të paguaj çmime më të larta sesa çmimet e konkurrencës dhe të dëmtoj buxhetin e komunës.. Shfrytëzimi i parasë së imët jashtë kuotave të parapara me rregulloren e shpenzimeve të parasë publike, rrit rrezikun që paraja e imtë të mos shfrytëzohet sipas destinimit të paraparë.

Rekomandimi 10 Kryetari duhet në veçanti t’i forcoj kontrollet e çertifikimit për të parandaluar të gjitha pagesat që ndërlidhen me artikujt e furnizuar jashtë kontratave, si dhe duhet të vendosë kontrolle që shpenzimet e parasë së imët të bëhen në pajtim me kërkesat të Rregullës 01/2013.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti i ndarë për kategorinë e subvencioneve dhe transfereve ishte 2,466€, ndërsa shpenzimi 2,400€.

Çështja 10 - Mungesa e rregullores për subvencione - Prioritet i lartë

E gjetura Në raportin e vitit të kaluar komuna ishte rekomanduar për hartimin e rregullores së brendshme për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve, mirëpo një rregullore e tillë ende nuk ishte nxjerrë nga komuna. Në mungesë të rregullores, subvencionet janë ndarë në bazë të vendimeve të Kuvendit të Komunës dhe që të gjitha shpenzimet ishin bërë për subvencionimin e lehonave.

Rreziku Mungesa e rregullores së brendshme për ndarjen e subvencioneve krijon paqartësi në përcaktimin e kriterëve se kush mund të jetë përfitues i subvencioneve. Kjo rrit rrezikun që subvencionet mos t'u ndahen personave në nevojë dhe të mos arrihen objektivat.

Rekomandimi 11 Kryetari duhet të hartoj një rregullore e cila specifikon qartë kriteret dhe procedurat për subvencionim dhe e njëjta të aprovohet në Kuvend Komunal.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 435,659€. Prej tyre në vitin 2016 ishin shpenzuar 330,719€ apo 76%. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin, asfaltimin dhe renovimin e rrugëve, ndërtimi monumentit të dëshmorëve etj.

Nga mostrat e testuara ne nuk kemi gjetur ndonjë çështje për ta ngritur në raport.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurive në komunë vazhdon të mbetet sfidë. Komuna nuk ka bërë regjistrimin e pasurive mbi 1,000€ në SIMFK dhe regjistrimet e pasurive nën 1,000€ në programin E-pasuria.

Çështja 11 - Mungesa e regjistrimit të pasurive- Prioritet i lartë

E gjetura Komuna kishte caktuar zyrtarin e pasurisë në vitin 2015, mirëpo ende nuk kishte filluar me regjistrimin e pasurisë me vlerë mbi 1,000€ në SIMFK. Përveç kësaj nuk bëhet regjistrimi i blerjeve të pasurive nën 1,000€, dhe stoqeve në programin E-pasuria. Pra, komuna nuk posedon asnjë regjistër për pasuritë të cilat i posedon.

Rreziku Mos regjistrimi i pasurisë në regjistrin kontabël vështirëson menaxhimin dhe përdorimin e drejtë të pasurive, si dhe vështirëson identifikimin e pasurive për të konfirmuar ekzistencën e tyre. Në mungesë të evidencave ekziston rreziku potencial që pasuritë të keqpërdoren, madje të humben dhe tjetërsohen pa u vërejtur nga menaxhmenti.

Rekomandimi 12 Kryetari duhet të ndërmerri masa të menjëhershme dhe të fillojë procesin e regjistrimit të të gjitha pasurive dhe stoqeve në dispozicion, si dhe të krijojë një regjistër të plotë dhe të besueshëm të pasurive.

3.2.2 Të arkëtueshmet

Komuna si llogari të arkëtueshme në fund të vitit 2016 ka raportuar vlerën prej 118,000€. Prej tyre, nga tatimi në pronë janë 84,000€ si dhe taksa në biznes janë 33,000€. Nëse e krahasojmë me vitin 2015 kur llogaritë e arkëtueshme kanë qenë 217,000€, vërehet një zvogëlim i këtyre llogarive dhe kjo ka ardhur si rezultat i vendimit të marrë nga Kuvendi Komunal me datën 29.03.2016 për lirimin nga taksa komunale të gjitha bizneset që janë pasive në Komunën e Mamushës.

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2016 ishte 55,385€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2017.

Çështja 12 - Rritja e obligimeve të papaguara - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Ne kemi analizuar obligimet e papaguara dhe nga kjo mund të konkludojmë se kemi një rritje të obligimeve nga viti në vit. Në vitin 2016 obligimet ishin rritur për 81% (55,385€) në krahasim me vitin 2015 (30,569€). Është i pakuptueshëm fakti se në fund të vitit obligimet e mbetura vetëm në kategorinë e investimeve kapitale ishin 46,452€ përderisa suficiti (mjetet e pashpenzuara) nga të hyrat vetjake ishin 96,058€.
- Rreziku** Mos pagesa e obligimeve me kohë ndaj furnitorëve, mund të ekspozoj komunën në vështirësi financiare dhe paraqet sfidë për vitin pasues për shkak se detyrimet e vitit të kaluar duhen paguar, ndërkaq ato të vitit aktual mund të mos përmbushen.
- Rekomandimi 13** Kryetari duhet të shqyrtoj në mënyrë kritike gjendjen e detyrimeve të papaguara, për të përcaktuar masat e nevojshme për adresimin e çështjeve të identifikuara, dhe pagesat të bëhen në kuadër të limiteve kohore të përcaktuara me rregullat financiare.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.1 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq-deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq-deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV dhe kërkesat tjera për raportim	Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për mos regjistrim të duhur të shpenzimeve në kategoritë adekuat. Është e nevojshme që të ndërmerren veprimet e duhura për t'i adresuar shkaqet që kanë ndikuar në theksim të çështjes, si dhe pasuritë të regjistruhen në SIMFK.			Jo
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari duhet të siguroj që është zbatuar plani i miratuar i veprimit, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.			Jo
2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të	Kryetari duhet të siguroj se është zbatuar kërkesa për plotësimin e pyetësorit të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive dhe sistematike.	Po		

MFK-së				
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Kryetari duhet sa më parë të miratoj një strategji të përgjithshme të menaxhimit të rrezikut, ku do të përcaktohet qartë qasja e menaxhmentit për reagime ndaj rreziqeve. Krahas identifikimit të rreziqeve në nivel operativ dhe strategjik, menaxhmenti duhet të hartoj edhe një plan veprimi ku përcaktohen masat e veprimit për të parandaluar dhe menaxhuar rreziqet e mundshme.			Jo
2.5.2 Raportimi Menaxherial	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri në fund të vitit 2016.			Jo
2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari i Komunës duhet të siguroj përmbushjen e kërkesës së UA nr.23/2009, respektivisht të rekrutoj një auditor të brendshëm. Nëse kjo kërkesë nuk mund të realizohet, atëherë shërbimi i auditimit të brendshëm, kryhet nga Ministria e Financave, apo ndonjë komunë tjetër. Shërbimi i auditimit, do të mbështeste menaxhmentin në vendimmarrje dhe eliminim të dobësive.			Jo

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.			Jo
3.3 Prokurimi	Kryetari duhet të siguroj një rishikim të rasteve të identifikuara për të gjetur shkaqet e ndodhjes dhe të marrë masat e duhura për evitimin e tyre në të ardhmen. Veçanërisht duhet të rris llogaridhënien e personave përgjegjës qoftë të njësisë kërkuese, zyrtarëve të prokurimit dhe menaxherëve të kontratave. Rrjedhimisht, duhen kontrole të shtuara për të siguruar që mbahen evidenca të sakta për shërbimet e kryera nga operatorët.		Pjesërisht është adresuare ky rekomandim nuk ka pasur raste ku malli është pranuar në kundërshtim me para masën dhe para llogarinë, mirëpo edhe më tutje ka mungesë kontroleve se ka pozicione që janë pranuar edhe pse nuk ishin në kontratën bazë.	
3.3.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Kryetari duhet të siguroj që kontratat të nënshkruhen mbi bazën e kriterëve të qarta dhe të bazuara në ligjin e punës. Zyrtarët e personelit duhet të kompletojnë dëshmitë për përvojën e punës për të krijuar bazë ligjore për ekzekutimin e shtesës në bazë të përvojës.		Pjesërisht është adresuare ky rekomandim edhe më tutje ka raste që janë lidhur kontrata për shërbime të veçanta në kundërshtim me kërkesat ligjore, nuk kemi identifikuar ndonjë çështje për ta ngritur në raport tek punëtorët e shëndetësisë dhe arsimit.	
3.3.2 Subvencionet	Kryetari duhet të hartoj një rregullore dhe të aprovet në kuvend, e cila specifikon qartë kriteret dhe procedurat për			Jo

dhe Transferet	subvencionim.			
3.4 Të Hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)	Kryetari të siguroj që fazën e planifikimit të buxhetit vjetor të shfrytëzoj të dhënat e viteve të kaluara dhe gjendjen aktuale që planifikimi të jetë sa më real. Përveç kësaj, duhet të monitoroj kontrollet aktuale të aplikuara në realizimin e të hyrave, dhe të evitohet mundësinë e keqpërdorimeve. Mjetet e inkasuara në të gatshme, të dorëzohen në bankë brenda afateve, siç përshihet me udhëzim.		Pjesërisht është adresuar ky rekomandim nuk ka pasur raste kur janë vonuar me depozitimin e mjeteve në bankë, mirëpo edhe më tutje tek taksat në biznes ka borxhe të lartë që komuna nuk ka krijuar mekanizma adekuatë për ti inkasuar.	
3.5 Pasuritë dhe detyrimet	Kryetari duhet të ndërmerr masa dhe të fillohet menjëherë me regjistrimet e pasurive, për menaxhimin e pasurive jo financiare dhe kërkesat në lidhje me regjistrimin dhe mirëmbajtjen e tyre duhet të aplikohen në tërësi.			Jo
3.5.2 Trajtimi i të arkëtueshmëve	Kryetari duhet ta shqyrtoj gjendjen e këtyre llogarive, të analizoj arsyet për akumulimin e këtyre shumave dhe të ndërmerr veprime efektive për maksimizimin e shkallës së inkasimit. Procesi i monitorimit sistematik të politikave për rritjen e inkasimeve, duhet të jetë gjithashtu pjesë e shqyrtimeve të rregullta të menaxhmentit.		Pjesërisht është adresuar ky rekomandim komuna ka marrë vendim për mes asamblesë komunale që tu shlyhen borxhet të gjitha bizneseve që janë pasive në komunë, mirëpo edhe më tutje mungojnë politikat adekuate që të arrijë ti inkasoj mjetet nga llogaritë e arkëtueshme.	

Shtojca IV: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti

Republika Kosova – Republic of Kosovo



Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës

Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi: Prishtinë

Datë: 10.05.2017

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Mamushës, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Arif Bütuç, Kryetar i Komunës së Mamushës

